



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401571/10

Tiranë ____/____/2015

Lënda: *Rekomandohet transferimi i të dënuarit Xh. K. në një IEVP më afër vendbanimit të familjes*

Drejtuar: **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**
Z. Artur ZOTO

TIRANË

I nderuar Z. Zoto,

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur jeni njohur me ankesën e të dënuarit Xh. K., i cili pretendonte se ishte transferuar pa të drejtë nga IEVP Fushë Krujë në IEVP Korçë dhe kërkonte të vuante dënimin në një IEVP më afër vendbanimit të familjes, Shkodra.

Në përgjigjen tuaj lidhur me këtë ankesë u vumë në dijeni se, ky i dënuar është problematik në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimit dhe ka konflikte me të dënuar të tjerë dhe me personelin. Në shkresën nr. 9307/4 Prot., datë 16.12.2014 dhe nr. 1781/1 Prot., datë 19.03.2015 thuhet se transferimi i Xheladin Krujës mund të realizohet në një moment më të përshtatshëm.

Referuar nenit 31 dhe 66 të Ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", transferimet duhet të favorizojnë mundësi që i dënuari ta kryejë dënimin pranë vendbanimit të familjes së tij. Gjykojmë se me hapjen e IEVP Fier është moment i përshtatshëm për të rishikuar mundësinë e transferimit të të dënuarit Xh. K. në këtë institucion ose edhe në IEVP të tjera ku të dënuarit në konflikt me Xh. janë liruar ose janë transferuar.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive."

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Rishikimin e mundësisë për transferimin e të dënuarit Xh. K. në një IEVP më afër vendbanimit të familjes.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI